RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA E KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0034/24
Data 22.05.2024
PRISHTINË

Në bazë të Nenit 29 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Nenit 36 paragrafi 10 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës me datën 22.05.2023 miratoi këtë:

RREGULLORE E FESTIVALIT TË KËNGËS NË RADIOTELEVIZIONIN E KOSOVËS

FESTIVALI I KËNGËS NË RTK

Maj, 2024

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1
FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES

1. Me këtë rregullore përcaktohet statusi, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i Festivalit të Këngës në RTK, me emrin ''FESTIVALI I KËNGËS NË RTK".

2. Me këtë rregullore në veçanti rregullohet:

   2.1. Themelimi, organizimi i brendshëm, veprimtaria dhe mirëfunksionimi i festivalit;

   2.2. Udhëheqja dhe drejtimi;

   2.3. Statusi, të drejtat dhe detyrat e të angazhuarve;

   2.4. Përzgjedhja e instrumentistëve të orkestrës, bashkëpunëtorëve profesional, ekspertëve dhe artistëve me famë ndërkombëtare;

   2.5. Pagesa e honorarëve të instrumentistëve të orkestrës, bashkëpunëtorëve profesional, ekspertëve e artistëve me famë ndërkombëtare;

   2.6. Çështje të tjera të rëndësishme për veprimtarinë e festivalit.

3. Kjo rregullore është pjesë e rregullativës së brendshme ligjore të RTK-së.

NENI 2
VEÇANTIA DHE RËNDËSIA INSTITUCIONALE

1. Ky festival, veç tjerash, ka për qëllim:

   1.1. Afirmimin dhe zhvillimin e potencialit krijues si dhe stimulimin e potencialit të përgjithshëm prodhues, interpretues e të performancës, në fushën e artit muzikor.

   1.2. Kultivimin e vlerave të vërteta muzikore dhe artistike.

   1.3. Ndikimin në kulturën e përgjithshme dhe kultivimin e shijes së mirë në publikun e gjerë;

   1.4. Stimulimin e veprimtarisë individuale dhe të përbashkët të artistëve, grupeve muzikore, ansambleve dhe orkestrave ekzistuese.

1.5. Prezantimi i Republikës së Kosovës në garën muzikore evropiane "Eurovision Song Contest".

1.6. Përcaktimin e mënyrës së përzgjedhjes së këngës e cila do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në gara ndërkombëtare përmes:

1.6.1 faza e aplikimit,
1.6.2 përzgjedhjes,
1.6.3 konkurrimit
1.6.4 finales së madhe;
1.6.5 publikimit dhe distribuimit

NENI 3
KARAKTERI DHE NATYRA INSTITUCIONALE

1. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" është aktivitet i përvitshëm i artit muzikor që organizohet e prodhohet nga Radiotelevizioni i Kosovës, rrjedhimisht të gjitha të drejtat e përgjithshme dhe ekskluzive mbi "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK", këngët dhe veprat që prezantohen në këtë festival janë pronë e patjetërsueshme e Radiotelevizionit të Kosovës (RTK).

2. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" prezanton vlerat krijuese në fushën e muzikës së lehtë, të popullarizuar, alternative dhe sub-kulturave të ndryshme.

3. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" është konkurs muzikor me karakter garues.

4. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" prezanton vlera të veçanta të performancës skenike.

5. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" duhet ta ketë orkestrën e vet e cila mund të kombinohet për nevoja specifike artistike.

6. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" transmetohet në të gjitha kanalet e RTK-së.

7. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" mund të transmetohet edhe nga transmetuesit e tjerë publik rajonal e botëror, me aprovim të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.

8. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" organizohet në javën e fundit të muajit tetor me aktivitete specifike të cilat i shërbejnë Festivalit. Në të hënën e javës së Festivalit mbahet konferenca për shtyp. "TAPETI I KUQ" organizohet në fillim të çdo nate të Festivalit dhe në netët e Festivalit përjashtuar natën finale, mbahet edicioni "POST FESTIVAL". Të dielën e javës së Festivalit mbahet edicioni maratonik së paku katër orësh "EXCLUSIVE POST FEST". Ndryshimi i këtij formati të realizimit mund të bëhet vetëm pas shqyrtimit dhe aprovimit nga Bordi i RTK-së.

NENI 4
VEPRIMTARIA E FESTIVALIT

1. Veprimtaria e "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" ushtrohet në mënyrë publike.

2. Veprimtaria e festivalit përfshin:

   2.1. Organizimin, përgatitjen dhe shfaqjen publike të koncerteve dhe formave tjera skenike - muzikore;

   2.2. Zhvillimin, kultivimin dhe nxitjen e vlerave të mirëfillta muzikore;

   2.3. Promovimin e të arriturave artistike dhe teknike;

   2.4. Botimin e spoteve reklamuese, informative e komerciale, si dhe ushtrimin e veprimtarive tjera me përmbajtje nga "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK";

   2.5. Incizimin, prodhimin, publikimin, distribuimin dhe promovimin e materialit muzikor;

   2.6. Bashkëpunimin me organizata, institucione tjera relevante dhe festivale të tjera të muzikës.

NENI 5
MËVETËSIA

1. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" është festival i rëndësishëm dhe i mëvetësishëm në skenën muzikore të Kosovës, me qëllim të ruajtjes, kultivimit dhe prezantimit të vlerave muzikore.

2. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" funksionon në kuadër të RTK-së.

NENI 6
SELIA DHE SIMBOLET E FESTIVALIT

1. Selia e "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" është në hapësirat e Radiotelevizionit të Kosovës në Prishtinë.

2. Festivali ka simbolet e veta të pandryshueshme identifikuese, institucionale dhe artistike:
   - stemat,
   - shenjat identifikuese
   - simbol i këngës fituese "Diamanti Blu i Kosovës"

– Simbolet e këngëve fituese të vendit të dytë dhe të tretë janë "Medaljonet në formën rrethore dhe varëse rripi".

3. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" ka vulat e mëvetësishme.

NENI 7
MJETET FINANCIARE PËR VEPRIMTARINË E FESTIVALIT

1. Mjetet financiare për zhvillimin efikas dhe të suksesshëm për punë, aktivitete dhe veprimtari të festivalit i siguron themeluesi, përkatësisht RTK-ja, në bazë të programeve e planeve financiare dhe projekteve paraprakisht të miratuara nga Bordi i RTK-së.

2. Themeluesi është i obliguar që Festivalit t'ia sigurojë kushtet optimale për punë:

   2.1.Zyrat përkatëse;

   2.2.Lokalet përkatëse për prova;

   2.3.Studiot për regjistrim të kolonave zanore

   2.4.Sallën për mbajtjen e provave dhe prezantimin e netëve të festivalit;

   2.5.Mjetet e nevojshme teknike për mbarëvajtje profesionale.

3. Në rastet kur themeluesi nuk mund të plotësojë kushtet sipas paragrafit 2 të këtij neni, RTK do të kontraktojë shërbime të specializuara në bazë të thirrjeve publike. Thirrjet publike si dhe procedurat tenderuese për festivalin realizohen përmes procedurave të ligjit për prokurim publik si dhe procedurave të rregulluara përmes rregulloreve të brendshme të RTK-së dhe direktivave të BE-së.

4. Festivali financohet nga Buxheti i RTK-së.

5. Themeluesi i festivalit, përkatësisht RTK-ja, është e obliguar që të sigurojë dhe vërë në dispozicion të festivalit të gjitha resurset teknike dhe strukturat profesionale e artistike të RTK-së, në shërbim të Festivalit.

6. Festivali me miratim nga Bordit të RTK-së mund ta zgjerojë bazën e vet materiale-financiare edhe nga burime të tjera të hyrash, në bazë të Ligjit të RTK-së.

7. "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" mund të sigurojë mjete edhe nga donacionet e sponsorizimet dhe ato mjete mund t'i përdorë për veprimtari plotësuese, përkatësisht për përmirësimin dhe zhvillimin e bazës materiale - financiare dhe të perspektivës më të mirë.

8. Destinimi i mjeteve financiare, duke përfshirë edhe mjetet shtesë të siguruara nga donacionet e sponsorisimet, me propozim të Drejtorit të Festivalit, përmes drejtorit të përgjithshëm duhet të miratohen nga Bordi.

NENI 8
KUJDESI PËR VEPRIMTARINË, INSTITUCIONIN DHE DOKUMENTACIONIN

1. Festivali është i obliguar që ta ruajë krijimtarinë muzikore, dokumentacion përkatës, mjetet e punës, rekuizitat, instrumentet, kostumet dhe pasurinë tjetër të festivalit.

2. Dokumentacioni me vlerë i festivalit ruhet në vende, orendi dhe stabilimente përkatëse, në përputhje të plotë me ligjin mbi ruajtjen e materialit arkivor dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare në këtë fushë.

3. Produkti final i festivalit siç transmetohet dhe regjistrohet në skenën e Festivalit (audio dhe video) mbetet pronë e përhershme e Radiotelevizionit të Kosovës dhe mund të shfaqet pa kufizime në të gjitha kanalet e Radio dhe Televizionit të Kosovës, si dhe në të gjitha platformat digjitale në pronësi të RTK-së.

4. E drejta e autorit për versionet e ripërpunuara të këngëve pjesëmarrëse në Festival i takon autorit/es të këngës. Autorët e këngëve pas gjashtë muajve mund të shfaqin në radio, televizion dhe platformat online versionet e ripërpunuara të këngëve pa kufizime.

KREU II
ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMI

NENI 9
ORGANET UDHËHEQËSE TË "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK"

1. Organet kolegjiale dhe individuale udhëheqëse të "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK" janë:

   1.1.Bordi i RTK-së;
   1.2.Drejtori i Përgjithshëm;
   1.3.Drejtori i Festivalit.

NENI 10
KUSHTET PËR EMËRIMIN DHE SHKARKIMIN E DREJTORIT TË FESTIVALIT

1. Drejtori i Festivalit emërohet në janar të çdo viti nga Bordi i RTK-së sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

2. Mandati i drejtorit të festivalit është 1 vjeçar.

NENI 11
DREJTORI I FESTIVALIT, KOMPETENCAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. Në cilësinë e përgjegjësit të festivalit, Drejtori i Festivalit kryen dhe udhëheq këto punë:

   1.1. Udhëheq punën e festivalit në tërësi

   1.2.E përfaqëson dhe i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm për veprimtarinë materiale-financiare dhe për ligjshmëri e afarizëm të festivalit;

   1.3.Zgjedh Drejtorin Artistik të Festivalit.

   1.4.Themelon Grupin e Punës së Festivalit dhe grupin e gjerë të punës.

   1.5.Përzgjedh anëtarët e Jurisë së festivalit dhe të Komisioneve të tjera.

   1.6. Së paku një herë në vit i raporton Bordit për mbarëvajtjen dhe të gjitha aktivitetet e Festivalit.

   1.7.Mbikëqyr punën dhe aktivitetet artistike të trupave artistike dhe këshillëdhënëse të përhershme dhe të përkohshme;

   1.8. Harton Planin dhe Strategjinë për Festivalin e Këngës dhe i paraqet para Bordit më së largu deri më 30 qërshor të çdo viti.

   1.9. Kryen dhe punë të tjera në lidhje me mbarëvajtjen e festivalit në pajtim me këtë rregullore dhe akte të tjera të RTK-së.

NENI 12
DREJTORI ARTISTIK I FESTIVALIT, KOMPETENCAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. Drejtori Artistik është person me përgatitje profesionale dhe integritet të lartë në fushën e muzikës.

2. Drejtori Artistik për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit të Festivalit.

3. Drejtori Artistik i Festivalit ka për detyrë, kompetencë dhe përgjegjësi që:

   3.1.Të koordinojë kompozitorët, orkestruesit dhe interpretuesit;

3.2. Ta propozojë planin artistik vjetor dhe strategjinë e realizimit të tij;

3.3. Të sigurojë me kohë arritjen e orkestrimeve dhe përshkrimin e partiturave për formacionet orkestrale;

3.4. Të sigurojë koordinimin me strukturat organizative të RTK-së, me qëllim të mbarëvajtjes së provave të rregullta, teknike, gjenerale dhe mbrëmjeve të festivalit;

3.5. Të ndërhyjë në paraqitjet e papërshtatshme skenike, në ndërrimin e solistëve dhe instrumentistëve në të mirë të prezantimit sa më në nivel të këngëve konkurruese; në koordinim me Drejtorin e Festivalit.

3.6. Të parashtrojë kërkesa ekskluzive për konceptin audiovizuel, në bashkëpunim me produksionin e RTK-së;

3.7. Të propozojë artistë apo grupe artistike (jashtë konkurrence) që do të interpretojnë në festival, t'ia paraqesë ato Drejtorit të Festivalit për miratim.

3.8. Kryen dhe punë të tjera në lidhje me mbarëvajtjen e festivalit në pajtim me këtë rregullore dhe akte të tjera të RTK-së.

NENI 13
GRUPI I PUNËS SË FESTIVALIT

1. Drejtori i Festivalit do të themelojë grupin e punës së Festivalit, i cili përbëhet nga:

1.1. **Producenti Ekzekutiv** - është përgjegjës për drejtimin ekzekutiv të gjithë procesit të organizimit skenik të festivalit, duke përfshirë koordinimin e aspekteve artistike dhe teknike, sigurimin e bashkëpunimit me artistët dhe ekipet e tjera, dhe koordinimin e detajeve të tjera në funksion të organizimit skenik të festivalit;

1.2. **Koordinatori Organizativ** – është përgjegjës për koordinimin e detajeve operative të festivalit, duke përfshirë logjistikën, ndërtimin e infrastrukturës, menaxhimin e vendosjes së artistëve dhe publikut, sigurimin e bashkëpunimit me autoritetet lokale për sigurinë, dhe menaxhimin e buxhetit të Festivalit;

1.3. **Regjisorët** – janë përgjegjës për planifikimin, organizimin, dhe drejtimin e transmetimeve televizive të festivalit;

1.4. **Skenaristët** - ngarkohen dhe mbajnë përgjegjësi për tekstin që flitet gjatë shfaqjes;

1.5. **Mjeshtri i skenografisë** – është përgjegjës për krijimin e pamjes së skenës dhe ambientit për performancat. Këtë punim skenik duhet ta realizojë grupi punues i skenës së festivalit.

1.6. **Eksperti i cilësisë së zërit në regjistrim/transmetim** – është përgjegjës për të garantuar cilësinë e lartë me standarde të zërit në produktin final (shfaqje dhe regjistrimet mbetëse).

2. Përveç profesionistëve të Grupit të punës së Festivalit, Drejtori i Festivalit do të themelojë edhe grupin e gjerë të punës së Festivalit, i përbërë nga të punësuarit e RTK-së. Udhëheqësit e të gjitha njësive të RTK duhet të lejojnë të punësuarit e RTK-së të bëjnë pjesë në grupin e festivalit.
3. Punonjësit e RTK-së kthehen në detyrat e tyre menjëherë pas përfundimit të edicionit të radhës të Festivalit të këngës.
4. Gjatë kohës së angazhimit në Festival, anëtarët e grupit të punës për punën e vet për punën që ndërlidhet me festivalin i raportojnë dhe i përgjigjen Drejtorit të Festivalit.
5. Anëtarët e të gjitha grupeve punuese të festivalit jane të punësuar të RTK-së. Të angazhuar nga jashtë mund të merren vetëm në rastet kur RTK nuk posedon me ato resurse njerëzore, dhe duhet dhënë një arsyetim nga drejtori i festivalit për ato propozime, të cilat duhet të miratohen nga Bordi i RTK-së.
6. Udhëheqësit e njësive njoftohen me kohë nga drejtori i festivalit për punonjësit që janë të nevojshëm të angazhohen në festival në mënyrë që zëvendësimet të bëhen me kohë që rrjedha e programit të njësive përkatëse të vijojë normalisht.

NENI 14

JURIA E FESTIVALIT

1. Drejtori i Festivalit do të formojë një juri në përbërje të profesionistëve të artit. Numri i anëtarëve të Jurisë së Festivalit është numër tek dhe nuk mund të jetë më shumë se 7 (shtatë) anëtarë. Të gjithë anëtarët e Jurisë së Festivalit janë të barabartë mes tyre. Anëtari i Jurisë së Festivalit nuk mund të jetë autor, bashkautor i kompozimit muzikor, i tekstit të këngës, si dhe nuk mund të jetë artist interpretues në cilësinë e këngëtarit të këngës pjesëmarrëse konkurruese në Festival. Anëtarët e jurisë duhet të jenë personalitete të artit, të muzikës dhe në përgjithësi të kulturës.

2. Juria e Festivalit është përgjegjëse për:

   2.1. shpalljen e çmimeve të Festivalit;

   2.2. çmimet e tjera krijohen me miratim nga bordi i RTK-së;

   2.3. çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë Rregullore.

NENI 15

KOMISIONI PËRZGJEDHËS I KËNGËVE

1. Drejtori i Festivalit do të zgjedhë anëtarët e komisionit përzgjedhës të këngëve. Kryetar i këtij komisioni është Drejtori Artistik dhe numri i përgjithshëm i anëtarëve të komisionit përzgjedhës të këngëve, është numër tek dhe nuk mund të jetë me shumë se pesë (5) anëtarë. Anëtari i komisionit përzgjedhës të këngëve konkurruese për pjesëmarrje në Festival në cilësinë e këngëve pjesëmarrëse konkurruese në Festival, nuk mund të jetë autor, bashkautor i kompozimit muzikor dhe/ose i tekstit të këngës, si dhe nuk mund të jetë artist interpretues në cilësinë e këngëtarit të këngës.

2. Komisioni përzgjedhës i këngëve është përgjegjës për:

   2.1. Përzgjedhjen dhe kualifikimin e këngëve në cilësinë e këngëve pjesëmarrëse konkurruese në Festival;

   2.2. çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë Rregullore.

NENI 16

RREGULLAT E PJESËMARRJES NË KONKURRIM, KRITERET DHE PËRZGJEDHJA E KËNGËVE

1. Këngët konkurruese në "Festivalin e Këngës në RTK" , duhet të dorëzohen në Radiotelevizionin e Kosovës, me të gjitha elementet përbërëse të këngës, në bazë të konkursit të shpallur paraprakisht dhe të përzgjidhen nga Komisioni Përzgjedhës.

2. Kënga e përfunduar (demo-version) duhet të dorëzohet në platformën elektronike të festivalit

3. Kënga duhet të jetë e kënduar domosdoshmërisht nga këngëtari/ja ose grupi, që pretendon ta interpretojë atë në festival.

4. Kënga duhet të jetë e krijuar enkas për festivalin e këngës dhe nuk duhet të jetë e publikuar as pjesërisht.

5. Teksti i këngës, duhet të jetë i shtypur në dy kopje.

6. Kënga nuk mund të jetë më e gjatë se 4 minuta e 30 sekonda.

7. Një këngëtar/e ka të drejtë të marrë pjesë në festival vetëm me një këngë.

8. Një kompozitor/e ka të drejtë të marrë pjesë në festival vetëm me një këngë.

9. Një autor teksti mund të marrë pjesë në festival me jo më shumë së dy tekste.

10. Një orkestrues mund të marrë pjesë në festival me jo më shumë së dy orkestrime.

11. Në momentin e dorëzimit në të këngës pranë Komisionit Përzgjedhës të Këngëve, duhet të deklarohen nominalisht në formularin e pjesëmarrjes të gjithë autoret e këngës (përfshirë dhe interpretët), të cilët pas nënshkrimit të tyre për autorësinë e këngës, nuk mund të ndryshohen.

12. Pas plotësimit të formularit, konkurrentët bëjnë dorëzimin e këngës për konkurrim në Komisionin Përzgjedhës për pjesëmarrje në festival.

NENI 17
SELEKSIONIMI I KËNGËVE

1. Përzgjedhjen e këngëve e bënë komisioni përzgjedhës, të cilët duhet të vijnë nga fusha artit dhe kulturës dhe fushave tjera relevante, sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kënga nuk mund të përmbajë mesazhe publicitare ose promocionale.

3. Kënga nuk duhet të përmbajë elemente, që bien në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për të Drejtat e Autorit si dhe të drejtat e tjera që lidhen me të.

4. Autorët e këngës si dhe këngëtari/ja nuk duhet të kenë funksione drejtuese, apo vendimmarrjeje në komisionin e seleksionimit të këngëve, jurinë e festivalit si dhe në stafin që punon për organizmin e festivalit.

5. Autorët e këngëve duhet ta trajtojnë me prioritet themeluesin e Festivalit, përkatësisht RTK-në, kur është fjala për paraqitjet televizive, bashkëpunimet dhe promovimin e tyre në vitin e pasues pas mbajtjes së festivalit.

KREU III

ANGAZHIMI DHE PAGESA E INSTRUMENTISTËVE TË ORKESTRËS, BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL, EKPERTËVE DHE ARTISTËVE ME FAMË NDËRKOMPBËTARE

NENI 18
Angazhimi i ekspertëve dhe i bashkëpunëtorëve të jashtëm për Festivalin e Këngës

1. Angazhimi i ekspertëve dhe i bashkëpunëtorëve të jashtëm për Festivalin e Këngës bëhet në këto raste:

1.1 Në mungesë të stafit adekuat të angazhuar me kontratë të rregullt të punës në RTK;

1.2 Kur projekti artistik ka kërkesa për numër më të madh të stafit artistik;

1.3 Kur në RTK nuk ka staf të rregullt artistik/teknik për angazhimin e caktuar.

2. Të angazhuarit e jashtëm duhet të jenë profesionistë dhe t'i përmbushin kriteret e kërkuara për angazhim në Festivalin e Këngës në RTK.

3. Angazhimi i instrumentistëve të orkestrës bëhet përmes thirrje publike, duke u bazuar në politikat dhe nevojat programore të RTK-së dhe programin artistik.

4. Angazhimi i ekspertëve dhe i artistëve me reputacion ndërkombëtar trajtohet në mënyrë të veçantë duke u përjashtuar nga procedura e paraparë si në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Shuma e kompensimit dhe pagesave të të angazhuarve dhe bashkëpunëtorëve në Festivalin e RTK-së, bëhet me propozimin të Drejtorit të Festivalit përmes drejtorit të përgjithshëm dhe miratim të Bordit.

NENI 19
Instrumentistët, orkestruesit dhe kompozitorët

1. Përzgjedhja e instrumentistëve të orkestrës së festivalit bëhet çdo vit përmes thirrjes publike, në bazë të kritereve të përcaktuara nga Drejtori Artistik në koordinim me Drejtorin e Festivalit dhe miratimin nga drejtori i përgjithshëm.

2. Thirrja publike bëhet për të gjithë instrumentistët, orkestruesit dhe kompozitorët që do të jenë pjesë e orkestrës në Festivalin e Këngës në RTK.

3. Thirrja publike do të jetë i shpallur për shtatë (7) ditë pune, me mundësi të zgjatjes së afatit edhe për pesë (5) ditë tjera të punës.

NENI 20
Komisionin përzgjedhës i orkestrës së Festivalit

1. Komisionin e përzgjedhjes së instrumentistëve të festivalit propozon Drejtori Artistik në koordinim me Drejtorin e Festivalit dhe e emëron Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë. Drejtori Artistik caktohet me mandat të përhershëm, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, derisa dy anëtarë tjerë duhet të jenë profesionistë të fushës, e nëse në RTK nuk ka të tillë, atëherë caktohet një tjetër me pozitë ekuivalente;

2. Komisioni i vlerëson kandidatët e paraqitur në konkursin publik;

3. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë respektive sipas kritereve të konkursit;

4. Komisioni përpilon listën përfundimtare të instrumentistëve të Festivalit duke u bazuar në pikët e anëtarëve;

5. Gjatë vlerësimit të komisionit mbahet procesverbal;
6. Lista e kandidatëve të suksesshëm botohet në ueb-faqen e RTK-së dhe gjatë ditës pasuese bëhet njoftimi tek të gjithë kandidatët për rezultatet e konkurrimit.

NENI 21
Pagesa e Instrumentistëve të orkestrës

Për shkak të pozicionit të veçantë të instrumentistëve të orkestrës së festivalit dhe pozicionit përcaktues të orkestrës në vet ekzistencën e festivalit të këngës, honoraret bëhen duke u bazuar në rregullativën e brendshme të RTK-së.

NENI 22
Angazhimi dhe pagesa e ekspertëve dhe artistëve me reputacion ndërkombëtar

1. Në funksion të nivelit artistik dhe vizual të Festivalit, në mungesë të burimeve ekzistuese, RTK mund të angazhojë ekspertë me standarde të larta profesionale në pozicionet specifike që garantojnë cilësinë programore të Festivalit. Megjithatë, duke marrë parasysh buxhetin e aprovuar për Festivalin, menaxhimi financiar duhet të jetë i balancuar dhe me projekt buxhet të detajuar.

2. Në kuadër të realizimit të Festivalit, Drejtori i Festivalit angazhon ekspertë dhe artistë me reputacion ndërkombëtar në disa pozicione specifike, ku RTK apo edhe tregu vendor nuk mund të sigurojë realizimin e proceseve të caktuara.

3. Drejtori i Festivalit përcakton shumën e pagesës për angazhimin e ekspertëve dhe artistëve me reputacion ndërkombëtar dhe i propozon Drejtorit të përgjithshëm për aprovim.

NENI 23
Angazhimi dhe pagesa e mysafirëve të ftuar dhe e prezantuesve të Festivalit

1. Drejtori i Festivalit vendosë për prezantuesit e Festivalit.

2. Drejtori i Festivalit në bashkëpunim me Drejtorin Artistik përpilon listën e mysafirëve të ftuar të Festivalit.

3. Drejtori i Festivalit, nëpërmjet drejtorit të përgjithshëm, duke u bazuar në rregullativën e brendshme, përcakton shumën e pagesës për angazhimin e mysafirëve të ftuar dhe prezantuesve si dhe i propozon bordit për miratim.

NENI 24
Lidhja e kontratës

1. Me të gjithë të përzgjedhurit lidhet kontrata për shërbime, në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe rregullativës së brendshme të RTK-së.

NENI 25
Pakoja e akomodimit

1. Me qëllim të nxitjes së pjesëmarrjes sa më të madhe të artistëve nga mbarë bota dhe prezantimit të dinjitetshëm të RTK-së karshi bashkëpunëtorëve të Festivalit të cilët vijnë nga vende të huaja, Festivali do të mbulojë shërbimet e akomodimit, udhëtimit dhe ushqimit për garuesit dhe mysafirët e Festivalit për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë.
2. Kontrata apo marreveshja mes paleve permbane aktivitetin ne festival, kohen e qendrimit dhe lartesine e pageses.
3. Vlera e përgjithshme e shpenzimeve të akomodimit për të gjithë të angazhuarit dhe bashkëpunëtorët në festival, nuk mund të kalojë 10% të buxhetit të përgjithshëm të Festivalit.

KREU III
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 26

1. Kjo rregullore mund plotësohet dhe ndryshohet me propozim të Drejtorit të Festivalit apo Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe shqyrtimit dhe miratimit nga Bordi i Radio Televizionit të Kosovës.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës dhe nënshkrimit nga kryetari i Bordit.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohen Rregullorja e Festivalit të Këngës në RTK dhe Rregullorja për Angazhimin e Ekspertëve, Bashkëpunëtorëve të Jashtëm dhe Audicionin për Festivalin e Këngës në RTK.

Kryetar i Bordit të RTK-së
Besnik Boletini

RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0045/26
Data 30.06.2026
PRISHTINË

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 29 paragrafit 2 nënparagrafit 2.2 të Ligjit Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, nenit 17 paragrafi 2, nënparagrafi 2 të Statutit nr. 0001/22 të RTK-së, Bordi i RTK-së, me datë 30.06.2026 miraton këtë:

RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 0034/24 PËR FESTIVALIN E KËNGËS NË RTK

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 0034/24 për Festivalin e Këngës në Radiotelevizionin e Kosovës, me qëllim harmonizimin e saj me organizimin e manifestimit muzikor "Akordet e Kosovës".

Neni 2

Në Nenin 1 paragrafi 1 i Rregullores bazë ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Me këtë rregullore përcaktohet statusi, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i Festivalit të Këngës në RTK, me emrin "FESTIVALI I KËNGËS NË RTK", i cili organizohet dhe zhvillohet si pjesë përbërëse e manifestimit muzikor "Akordet e Kosovës".

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje:

2. "Akordet e Kosovës" është manifestim muzikor i Radiotelevizionit të Kosovës që përbëhet nga:

   a) Dy mbrëmje të Festivalit të Këngës në RTK;

   b) Një mbrëmje e Këngëve për Fëmijë.

Neni 3

Në Nenin 3 të Rregullores bazë, pas paragrafit 1 shtohet paragraph 2 me këtë përmbajtje:

2. "Akordet e Kosovës" paraqesin manifestimin muzikor vjetor të RTK-së, në kuadër të të cilit organizohen Festivali i Këngës në RTK dhe Mbrëmja e Këngëve për Fëmijë.

Neni 4

Në Nenin 4 të Rregullores bazë, pas paragrafit 2.6 shtohet paragrafi 2.7 me këtë përmbajtje:

2.7. Manifestimi muzikor "Akordet e Kosovës" organizohet në tri mbrëmje:

a) Mbrëmja e parë e Festivalit të Këngës në RTK;

b) Mbrëmja e dytë e Festivalit të Këngës në RTK;

c) Mbrëmja e Këngëve për Fëmijë.

Neni 5

Në Nenin 6 të Rregullores bazë, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

3. Manifestimi muzikor në kuadër të të cilit organizohet Festivali i Këngës në RTK mban emrin "Akordet e Kosovës".

Neni 6

Në Nenin 14 të Rregullores bazë, pas paragrafit përkatës shtohet paragrafi 3 me këtë përmbajtje:

3. Për Mbrëmjen e Këngëve për Fëmijë formohet juri e veçantë. Për përbërjen dhe funksionimin e saj zbatohen dispozitat e Nenit 14 të Rregullores bazë.

Neni 7

Pas Nenit 17 të Rregullores bazë shtohet Neni 17A me këtë përmbajtje:

Neni 17A

Mbrëmja e Këngëve për Fëmijë

1. Mbrëmja e Këngëve për Fëmijë organizohet si pjesë përbërëse e manifestimit muzikor "Akordet e Kosovës".
2. Për Mbrëmjen e Këngëve për Fëmijë aplikohen përshtatshmërisht dispozitat e Rregullores bazë për Festivalin e Këngës në RTK, përveç rasteve kur me këtë Rregullore përcaktohet ndryshe.
3. Të drejtë pjesëmarrjeje në Mbrëmjen e Këngëve për Fëmijë kanë fëmijët të cilët, në datën e zhvillimit të festivalit, janë të moshës nga 9 deri në 14 vjeç.

Neni 8

Dispozita kalimtare

Dispozitat e Rregullores Nr. 0034/24 për Festivalin e Këngës në Radiotelevizionin e Kosovës, të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë Rregullore, vazhdojnë të mbeten në fuqi.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Xheraldina Cërnobregu

Nënkryetare e Bordit të RTK-së